

# A JENI NJE PROFESIONIST QE PUNON ME TE RINJTE?

**DISA PREJ TYRE PO VUAJNE ME MENDIME SEKSUALE NDAJ FEMIJEVE TE VEGJEL  
ATA KANE NEVOJE PËR TY SI NJË "I RRRITUR I BESUAR"!**

## Të kuptojmë çështjen

Të rinjtë zakonisht fillojnë të zhvillojnë interesa seksuale tek të tjerët rreth fazës së pubertetit, dhe disa mund të përjetojnë nxitje ose interesa seksuale edhe më herët. Të kesh një interes seksual për bashkëmoshatarët kur rritesh është krejtësisht normale dhe nuk ka asgjë për t'u shqetësuar në përgjithësi. Ndonjëherë i riu ka mendime ose ndjenja seksuale për fëmijët dhe kjo mund t'ju ngatërrojë si profesionist. Mos harroni se nuk keni nevojë të jeni ekspert për tu përballur me respekt me të rinjtë dhe për t'u ofruar mbështetje në procesin e reflektimit mbi seksualitetin e tyre.

## Roli i profesionistëve

Si një profesionist që punon me të rinjtë, shpesh jeni pika e parë e kontaktit për ata që luftojnë me këto mendime dhe ndjenja. Veprimi i menjëhershëm dhe i duhur është i një rëndësie të madhe, siç është konsultimi me profesionistë të tjerë për një plan trajtimi gjithëpërfshirës. Në situatat kur ju si profesionist shqetësoheni për mendimet dhe ndjenjat e të riut që përshkallëzohen në nivelin e sjelljes, ju keni një përgjegjësi profesionale për të trajtuar çështjen dhe për të raportuar për situatën në përputhje me ligjet dhe udhëzimet në fuqi.

## Raportimi dhe Konsultimi Profesional

Njohja e treguesve të mendimeve seksuale për fëmijët tek të rinjtë kërkon një kuptim bazë të çështjes. Bashkëpunimi me kolegë të trajnuar, veçanërisht ata me përvojë në trajtimin e individëve me mendime seksuale ndaj fëmijëve, është thelbësor për ofrimin e kujdesit dhe mbështetjes më të mirë si mekanizmi juaj kryesor i përgjigjes. Megjithatë, nëse dyshoni për shfrytëzim ose abuzim seksual, është detyra juaj t'ia raportoni atë autoriteteve kompetente.

# VEPRIMI NË INTERESIN MË TË LARTË TË TË RINJVE

Shumica e individëve kurrë nuk veprojnë sipas mendimeve të tyre të papërshtatshme seksuale. Si një i rritur i besuar, ju mund të ofroni forma të ndryshme mbështetjeje:

- 1. Mbështetje emocionale:** Krijoni një hapësirë jo-gjyquese, konfidenciale dhe të sigurt për të rinjtë që të shprehin shqetësimet e tyre.
- 2. Udhëzime dhe këshilla:** Ofroni udhëzime për të kërkuar ndihmë profesionale për shëndetin mendor dhe për të kuptuar detyrimet ligjore.
- 3. Siguria dhe Mbrojtja:** Jepini përparësi sigurisë së viktimave të mundshme dhe bëni të qartë se çdo dëm i mundshëm ndaj fëmijëve është i papranueshëm.
- 4. Zhvillimi moral dhe etik:** Diskutoni rëndësinë e sjelljes etike dhe pasojat e veprimeve të papërshtatshme.
- 5. Modelimi i roleve:** Demonstroni sjellje të përgjegjshme duke kërkuar ndihmë profesionale kur përballeni me çështje sfiduese.
- 6. Komunikimi:** Mbani dialog të hapur duke theksuar nevojën për ndërhyrje profesionale.
- 7. Zgjidhja e konfliktit:** Zbutja e çdo rreziku të mundshëm që lidhet me mendimet e papërshtatshme të të riut dhe adresimi i tyre duke u fokusuar në zgjidhje ligjore dhe të përshtatshme.
- 8. Menaxhimi i krizës:** Jini të përgatitur për të ndihmuar në kriza ose emergjenca që lidhen me këto mendime ose sjellje.
- 9. Advokimi:** Advokoni për mirëqenien e të riut duke siguruar masa për mbrojtjen e fëmijëve për të parandaluar dëmtimin e viktimave të mundshme.
- 10. Ndërtimi i vetëvlerësimit:** Inkurajoni rritjen personale të të rinjve dhe vetëvlerësimin e shëndoshë duke adresuar problemet e tyre përmes ndihmës profesionale.

## PARANDALIMI I PËRGJITHSHËM

Edukimi është çelësi për parandalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual. Mësojini të rinjtë mbi:

### Parandalimin e dëmit:

Rëndësia e respektimit të kufijve dhe pëlqimit.

### Pasojat ligjore:

Pasojat e rënda të veprimeve seksuale që përfshijnë fëmijë.

### Mirëqenien Emocionale:

Ndërtimi i marrëdhënieve të shëndetshme të bazuara në respektin reciprok.

### Fuqizimin:

Marrja e vendimeve të informuara për trupin dhe marrëdhëniet.

### Parandalimin e viktimizimit:

Edukimi i të rinjve për sjelljen seksuale ndaj fëmijëve për t'i parandaluar ata të jenë viktimë ose të shkaktojnë dëm pa dashje

Si një i rritur i besuar, roli juaj është thelbësor në trajtimin e kësaj çështjeje të ndjeshme. Ruajtja e një ekuilibri midis besimit dhe konfidencialitetit gjatë ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme është thelbësore. Dialogu i hapur, përgjigjet e sinqerta dhe sigurimi i burimeve janë çelësi për pajisjen e të rinjve me njohuri për të marrë vendime etike dhe për të parandaluar dëmtimin. Sigurimi i një mjedisi të sigurt ku ata ndihen rehat për të folur pasqyron një qasje gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme për ruajtjen e mirëqenies së të rinjve me të cilët angazhoheni.



CHILD SEXUAL  
ABUSE PREVENTION  
AND EDUCATION



Save the Children



Funded by  
the European Union

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author only and do not necessarily reflect those of the European Union or European Commission. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.